
APPLICATION OF SPECIAL INVESTIGATIVE MEASURES

Muhamet Racaj

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, kbiznesi@gmail.com

Senat Saliu

American University of Europe – FON, Skopje, N. Macedonia

Arianit Racaj

Army of the Republic of North Macedonia

Abstract: Special investigative measures in the prevention and detection of organized crime has a special importance in the system of evidentiary tools, considering the way these actions are executed, the value of the protective case, the perpetrators and the implications that arise from these works, whether they are individual or with a more general inquiry.

The research on this evidentiary tool expands the interest of the study on the possibility for misuse of these probation tools, the supervision of the application manner and eventual sanctioning, to disable them from the mechanism for individual and collective protection, and from asocial behaviors to turn into mechanisms that affect the fundamental rights of the citizens which are guaranteed by the International Constitution.

The utilization of special investigative means can be made only if the court gives an order which is established by the prosecutor's proposal.

It is obvious that the application of special investigative means, such as pursuing, photographing, recording and other measures, risk the democracy of a country as well as the rights and the fundamental freedoms of the people. On the other hand there is a fundamental belief that democratic values are threatened by the sophisticated forms of criminality, therefore states should possess various tools for countering this phenomenon. Only for this reason this compromise is accepted, as long as the application of these special investigative measures is set in clear legal frameworks, so the possibility of their misuse will be reduced. It is a fact that these measures restrict the private life of citizens. The court for human rights in Strasburg admits that the application of special investigative measures as a special instrument of democratic societies is necessary in the prevention and persecution of criminality. But if their application is not adequately regulated, there is a possibility of a collapse of democracy with the justification that it is done for its protection.

Keywords: special investigative measures, criminality, criminal offenses.

APLIKIMI I MASAVE TË VEÇANTA HETUESE

Muhamet Racaj

Kolegji "Biznesi" – Prishtinë, kbiznesi@gmail.com

Senat Saliu

American University of Europe – FON, Shkup

Arianit Racaj

Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Abstrakt: Masat e posaçme hetimore në parandalimin dhe zbulimin e krimit të organizuar kanë një rëndësi të veçantë në sistemin e mjeteve provuese, duke marrë parasysh mënyrën e ekzekutimit të këtyre veprimeve, vlerën e çështjes mbrojtëse, autorët dhe implikimet që rrjedhin nga këto vepra, qofshin ato individuale apo me një hetim më të përgjithshëm.

Hulumtimi mbi këtë mjet dëshmuës zgjeron interesin e studimit mbi mundësinë e keqpërdorimit të këtyre mjeteve të provës, mbikëqyrjen e mënyrës së aplikimit dhe sanksionimin përfundimtar, për t'i çaktivizuar ata nga mekanizmi për mbrojtjen individuale dhe kolektive, dhe nga sjelljet shoqërore për t'u kthyer në mekanizma që prekin të drejtat themelore të qytetarëve të cilat garantojnë nga Kushtetuta Ndërkombëtare.

Përdorimi i mjeteve të posaçme hetimore mund të bëhet vetëm nëse gjykata jep një urdhër i cili përcaktohet nga prozimi i prokurorit.

Shtë e qartë se zbatimi i mjeteve të veçanta hetimore, të tilla si ndjekja, fotografimi, regjistrimi dhe masa të tjera, rrezikojnë demokracinë e një vendi, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të njerëzve. Nga ana tjetër ekziston një besim themelor se vlerat demokratike kërcënohen nga format e sofistikuar të kriminalitetit, prandaj shtetet duhet të kenë mjete të ndryshme për t'iu kundërvënë këtij fenomeni. Vetëm për këtë arsye ky kompromis pranohet, për sa

kohë që zbatimi i këtyre masave të posaçme hetimore vendoset në korniza të qarta ligjore, kështu që mundësia e keqpërdorimit të tyre do të zvogëlohet. Ashtë fakt që këto masa kufizojnë jetën private të qytetarëve. Gjykata për të drejtat e njeriut në Strasburg pranon se zbatimi i masave të posaçme hetimore si një instrument i veçantë i shoqërive demokratike është i domosdoshëm në parandalimin dhe persekutimin e kriminalitetit. Por nëse zbatimi i tyre nuk rregullohet në mënyrë adekuate, ekziston mundësia e një kolapsi të demokracisë me arsyetimin se është bërë për mbrojtjen e saj.

Fjalët kyçe: masa të posaçme hetimore, kriminaliteti, veprat penale.

1. HYRJE

Për të parandaluar dhe luftuar forma të rënda të kriminalitetit, patjetër të shfrytëzohen metoda të caktuara "specifike" të ashtuquajtura masa të veçanta hetuese, të cilat nuk janë të përditshme dhe të zakonshme të kriminaliteti "klasik" ose "konvencional". Përdorimi i masave të veçanta hetuese rrit efikasitetin e autoriteteve të ndjekjes penale në luftën kundër formave të sofistikuara të kriminalitetit siç janë krimi organizuar, korrupsioni, spiunazhi, terrorizmi etj.

Aplikimi i masave të veçanta hetuese ka rëndësi të madhe në sistemin e masave provuese, duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së veprave penale, kryerësit e veprave penale, si dhe pasojat nga këto vepra, qoftë të jenë të karakterit individual apo me karakter të gjerë shoqërorë.

Hulumtimi i këtyre elementeve zgjon interes në studimin e mundësisë për keqpërdorimin e këtyre provave materiale, mbikëqyrjen (vëzhgimin) e mundësisë të aplikimit dhe sanksionin eventual, me qëllim të pamundësohen ato mekanizma për mbrojtjen individuale dhe kolektive të sjelljeve devijante, të konvertohen në mekanizma që do të cenonjë të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve, të garantuara me Kushtetutë dhe aktet ndërkombëtare.

Aplikimi i masave të veçanta hetuese zbatohen vetëm me urdhër gjyqësor me propozim të Prokurorisë.

E qartë është se aplikimi i masave të veçanta hetuese, siç janë: përcjellja dhe incizimi, vëzhgimi i fshehtë, etj., janë kërcënim për demokracinë e një shteti dhe për të drejtat themelore demokratike të njeriut. Nga ana tjetër, megjithatë ekziston një bindje përgjithësisht e pranuar, se vlerat themelore demokratike janë të cenuara nga format e ndryshme të sofistikuara të kriminalitetit, dhe për këtë arsye, shtetet patjetër të posedojnë mjete për refuzimin e këtij fenomeni.²⁴¹ Pikërisht për këtë është arritur një kompromis, dhe kjo është aplikimi i këtyre masave të veçanta hetuese të vendoset në kornizë të qartë juridike, që të zvogëlohet mundësia për keqpërdorimin e tyre. Fakt është se këto masa të veçanta hetuese e kufizojnë privatësinë e qytetarit. Gjykata për të drejtat e njeriut në Strasburg pranon se është e domosdoshme nevoja të përdoren këto masa të veçanta hetuese si instrument special në shoqëritë demokratike, me qëllim parandalimin dhe ndjekjen e kriminalitetit. Mirëpo, nëse aplikimi i tyre nuk është në përputhje me dispozitat ligjore, ekziston mundësia për rrëzimin e demokracisë me pretext dhe me arsyetim se bëhet për mbrojtjen e tyre.

2. BAZA JURIDIKE PËR APLIKIM TË MASAVE TË VEÇANTA HETUSE

Me ndryshimin e Amendamentit XIX të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2003, është përcaktuar spektri i privatësisë që mbrohet (liria dhe paprekshmëria), si dhe sferat e mbrojtjes (letrat dhe të gjitha format e tjera të komunikimit) të privatësisë së individit. Theksohen katër parimet themelore që përcaktojnë zbatimin e masave invazive dhe bazat legjitime për zbatimin e këtyre masave:

- 1) Parimi i miratimit gjyqësor të masave ("vetëm në bazë të vendimit të gjykatës");
- 2) Parimi i ligjshmërisë ("nën kushte në procedurë të paraparë me ligj") ceken në mënyrë eksplicite,
- 3) Parimi i subsidiaritetit, nga më pak invazive në më shumë invazive,
- 4) Parimi i proporcionalitetit, ashtu si edhe në nenin 8 të KEDNj-së, nënkupton përkufizimin terminologjik të termit të përdorur *domosdoshmërisht* ("nëse kjo është e domosdoshme").²⁴²

Zbatimi i masave të tilla rregullohet saktësisht me Ligjin për Procedurë Penale, Ligji për ndjekjen e telekomunikimeve, dhe ligje tjera. Parashihet përdorimi i tyre vetëm në raste të përcaktuara rreptësisht, kur ka të ngjarë që të sigurohen të dhënat dhe provat e nevojshme për vazhdimin me sukses të procedurës penale, të cilat dëshmi nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër. Ndryshimet në Ligjin për Procedurë Penale të vitit 2004 dhe ndryshimet e mëvonshme në vitin 2010 futën masa shtesë për hetim të suksesshëm të kriminimit të organizuar dhe krime të tjera të rënda. Me këto ndryshime parashihen dymbëdhjetë masa të veçanta hetuese.²⁴³

²⁴¹ Камбовски В. Организиран криминал, Скопје, 2005

²⁴² Andonova S., Bozhinovski A., dhe të tjerë, *Doracak për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve*, Geneva Centre for Security Sector Governance, Shkup, dhjetor 2019, fq. 45.

²⁴³ N.Etemi, *Taktika Kriminalistike – 2*, Gostivar, 2020, fq. 152-153

3. LLOJET E MASAVE TË VEÇANTA HETUESE

Lufta kundër formave të rënda të krimit (sidomos kundër krimit të organizuar) është e pamundur pa zbatimin e masave bashkëkohore të hetimit në fushën e të drejtës penale. Pikërisht për këtë ligjvënësi ka futur masa të veçanta hetuese, me zbatimin e të cilëve për nevojat e procedurës penale sigurohen të dhëna dhe prova për të cilat në mënyrë tjetër nuk mund të mblidhen. Ligjvënësi i Republikës së Maqedonisë të Veriut i ka parashikuar masat e veçanta hetuese si më poshtë:

- 1) **Përcjellja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike në procedurën e përcaktuar me ligj të veçantë.** Përcjellja e komunikimeve është e rregulluar me Ligjin për procedurë penale, Ligjin për ndjekjen e komunikimeve, Ligji për komunikimet elektronike dhe Ligji për agjencinë teknike – operative.²⁴⁴ Ligjvënësi thekson se ndjekja e komunikimeve duhet të bëhet në mënyrë dhe procedurë me të cilën nuk cenohen të drejtat dhe liritë e njeriut dhe se çdo keqpërdorim paraqet vepër penale sipas Kodit Penal të RMV-së. Në përputhje me dispozitat të Ligjit për Agjencinë operative- teknike(AOT),²⁴⁵ Agjencinë operative- teknike (AOT) për kryerjen e kompetencë aktivizon dhe krijon kushte teknike për ndjekjen e komunikimeve për: hetime penale dhe mbrojtje të interesave për sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit. Për t'u krijuar kushte teknike AOT: mundëson lidhje teknike ndërmjet operatorëve dhe aparatit ndërmjetësues (LEIMD) të instaluar në AOT; mundëson lidhshmëri teknike ndërmjet aparateve teknike (LEIMD dhe LEMF) të vendosura në AOT; mundëson lidhshmëri teknike ndërmjet aparatit teknik (LEMF) të vendosur në AOT dhe stacionet e punës që përdoren për realizimin e ndjekjes së komunikimeve të vendosura në hapësirat e organeve të autorizuara. Te hapësira memorike e aparatit teknik (LEMF) mund të arrihet vetëm nëpërmjet stacioneve të punës në organet e autorizuara. Përmbajtja e komunikimit të ndjekur në aparatit teknik (LEMF) automatikisht kriptohet. AOT mundëson mirëmbajtje të aparateve teknike të vendosura në AOT, si dhe vendosje të masave dhe proceseve për shmangie të ndërhyrjeve të brendshme dhe të jashtme kompjuterike dhe hakerimit, si dhe çdo lloj keqpërdorimi nga ana e të punësuarve në AOT. AOT kryen mbikëqyrje profesionale në punën e operatorëve. Mënyrën e kryerjes së punëve e përcakton drejtori i AOT. Organi i autorizuar për ndjekjen e komunikimeve i përcakton masat dhe standardet për sigurinë e informacionit, të cilët duhet ti zbatojë operatori në rrjetet komunikuese elektronike publike dhe/se shërbimet në lidhje me detyrimet e tij për ndjekjen e komunikimeve. Operatorët kanë obligim ti mundësojnë organit të autorizuar për ndjekjen e komunikimeve, ndjekjen e komunikimeve në kohë reale. Informacioni për ndjekjen e komunikimeve duhet të jetë në dispozicion menjëherë pas përfundimit të komunikimit, ndërsa ndjekja e komunikimeve duhet të jetë pa ndërprerë për gjithë kohëzgjatjen e tij. Operatorët gjithashtu kanë obligim të sigurojnë lidhjen e saktë dhe të një kuptimit të informacionit për komunikimin e ndjekur me përmbajtjen e komunikimit e cila ndiqet.²⁴⁶
- 2) **Përcjellja dhe incizimi në shtëpi, lokal të mbyllur ose të rrethuar që i takon asaj shtëpie ose lokal afarist të shënuar si privat ose në automjet dhe hyrje në ato lokale për krijimin e kushteve për ndjekjen e komunikimeve.** Kjo masë mund të përcaktohet nga gjykatësi i procedurës paraprake me urdher me shkrim, por vetëm me një kërkesë të arsyeshme nga prokurori publik që tregon arsyet për përsjelljen dhe incizimin dhe të cilat kërkojnë përcaktimin e masës dhe rezultatet e pritura. Ekziston një kufizim i qartë se kjo masë mund të drejtohet vetëm në ambientet (shtëpi, hapësira të mbyllura ose të rrethuara që i përkasin atij ambienti ose hapësirë afariste të shënuar si privat) ose automjetet që i përkasin një personi të dyshuar.Me përjashtim, masa lejohet edhe në shtëpinë e personave tjerë (që nuk kanë cilësinë e të dyshuarit), vetëm në bazë të dyshimit të bazuar se aty qëndron i dyshuari. Gjithashtu, nëse në shtëpinë e të dyshuarit do të gjenden anëtarë tjerë të familjes, incizimi duhet patjetër të ndërpritet nëse përcillen thënie ose veprime që kanë të bëjnë me sferën intime dhe private ose të jetës familjare dhe nuk kanë asnjë lidhshmëri me qëllimin për të cilin është përcaktuar masa. Dokumentacioni për dëshmitë e atilla duhet menjëherë të asgjësohet.²⁴⁷ Vazhdimin e masës më së gjati për katër muaj tjerë mund ta lejojë gjykatësi i procedurës paraprake, pas kërkesës së arsyetuar me

²⁴⁴ Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 150/110; Ligji për ndjekjen e komunikimeve, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.4/09, 116/12; Ligji për komunikimet elektronike, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18, 21/18; Ligji për Agjencinë teknike-operative, Gazeta Zyrtare e Rm-së, nr.71/18.

²⁴⁵ Ligji për agjencinë operative tektike (Gazeta Zyrtare e RM, nr 71, 2018). Neni 3

²⁴⁶ Shiko më shumë: https://www.analyticamk.org/images/Files/impossible_mk_final_95921.pdf

²⁴⁷Neni 268 i LLP.

- shkrim të prokurorit publik.²⁴⁸
- 3) **Përcjellja dhe incizimi i fshehtë i personave dhe sendeve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose lokalit afarist të shënuar si privat.** Kjo masë paraqet vëzhgimin e përkohshëm të fshehtë (ose të maskuar), të planifikuar të personit të caktuar, objektit ose vendit, me qëllim realizimin e këqyrjes të përshtatshme të objektit për ngjarjen me interes të veçantë. Masa mund të zbatohet vetën ndaj të dyshuarit, ndërsa në lidhje me personat tjerë, mund të urdhërohet nëse vetëm rrethanat e parashikuara drejtojnë në atë se ato persona janë të lidhura me të dyshuarin ose lidhje e tillë vendoset dhe se masa do të çojë në zgjidhjen e të gjithë situatës ose në zbulimin e vendbanimit, ndërsa sidomos kur e njëjta nuk mund të dëshmohet në mënyrë tjetër. Përveç atëherë, masa mund të zbatohet edhe kur me atë padyshim përfshihen edhe persona tjerë.²⁴⁹
 - 4) **Shikimi i fshehtë dhe kontrollimi i sistemit kompjuterik.** Në kushte kur veprat penale kryhen edhe përmes përdorimit dhe keqpërdorimit të kompjuterit, gjegjësisht sistemit kompjuterik, organeve të ndjekjes (me qëllim ti zbulojnë, dëshmojnë dhe sqarojnë veprat e tilla) u jepet mundësi, në rast kur ekzistojnë baza të dyshimit se është kryer ndonjë formë paraqitëse të krimit kompjuterik, të zbatohet masën shikim i fshehtë dhe kërkim në sistemin kompjuterik (i cili është në pronësi të personit fizik ose juridik).
 - 5) **Kërkimi automatik ose në mënyrë tjetër, kërkimi dhe krahasimi i të dhënave personale.** Masa përbëhet në kërkimin automatik ose në mënyrë tjetër dhe zbatimin e mbledhjes të të dhënave personale të personave dhe të dhëna tjera që drejtpërdrejtë janë të lidhura me ato dhe krahasimi i tyre me karakteristika të caktuara të personit për të cilin, se në baza e supozimit është në lidhje me veprën penale, me qëllim të përjashtohen personat të cilët nuk janë të dyshuar ose të përcaktohen personat që i posedojnë karakteristikat që janë të nevojshme për hetimin. Përmes zbatimit të kësaj mase personi i cili kontrollohet hynë në rrethin e personave të dyshuar për veprën e kryer penale ose gjatë mos ekzistimit të rrethanave të tilla mund të eliminohet si autorë eventuale i veprës penale.²⁵⁰ Qasja në sistemet kompjuterike dhe në përpunimin kompjuterik të të dhënave ka të bëjë me krahasimin e të dhënave personale të qytetarëve që janë përpunuar në baza të duhura me të dhënat dhe regjistrat të cilët gjenden në kuadër të evidencës policore. Njohuria për personin e kërkuar të futur në një regjistër të të dhënave personale krahasohet me bazën tjetër të të dhënave në të cilën personi i tillë do të mund të gjendet. Rezultati i fituar i tillë mund të japë më shumë të dhëna për personin për të cilin ekziston dyshim se ka kryer vepër penale. Kërkimi pozitiv (rastër) përdoret për përcaktimin e rrethit të personave të dyshuar duke filluar nga karakteristikat të caktuara regjistruese. Kërkimi negativ (rastër) e përjashton nga kërkimi i mëtejshëm personin e caktuar i cili nuk është i dyshuar.²⁵¹ Personat fizik dhe juridik të cilët bëjnë përpunimin e të dhënave personale janë të detyruar të mundësojnë kryerjen e lirshme të urdhrin për zbatimin e masës kërkimi automatik ose në mënyrë tjetër, kërkimi dhe krahasimi i të dhënave personale. Për arritjen e qëllimeve nga zbatimi i kësaj mase, personat fizik dhe juridik janë të detyruar të dhënat personale tua dorëzojnë organeve kompetente. Nëse nuk ngrihet procedurë penale, të gjitha të dhënat personale të mbledhura fshihen ose shkatërrohen nën mbikëqyrje të gjykatësit të procedurës paraprake, prokurorë publik dhe përfaqësues të Drejtorisë për mbrojtje të të dhënave personale (për të cilin prokurori publik do të përpilojë procesverbal).
 - 6) **Shikimi në komunikimet telefonike ose komunikimet tjera të realizuara elektronike.** Kjo masë mundëson përgatitjen e matricave të komunikimeve të vendosura, gjegjësisht jep mundësi të kryhet shikim në komunikimet telefonike ose të tjera elektronike për personat të cilat ekzistojnë bazë se: përgatitin, fshehin ose kanë kryer vepër të caktuar penale. Qëllimi i të njëjtës, është të analizohen kontaktet me personat e dyshuar dhe me të tjerët të involvuar në vetë situatën kriminale, që veçanërisht analizohet koha, vendi i kontakteve të realizuara, më shpesh përmes telefonit celularë. Por, me zhvillimin e sistemeve kompjuterike komunikimi gjithnjë e më shumë bëhet edhe përmes postës

²⁴⁸Për veprat penale për të cilat është përcaktuar dënimi me burg prej së paku katër vitesh për të cilat ekzistojnë dyshim i bazuar se janë kryer nga ana e grupit të organizuar, bandës ose shoqatës tjetër kriminale, gjykatësi i procedurës paraprake mund ta vazhdojë afatin nga paragrafi (2) të këtij neni për më së gjati 6 muaj, pas kërkesës me shkrim të prokurorit publik, e në bazë të vlerësimit të dobisë nga të dhënat e mbledhura me zbatimin e masës dhe në bazë të pritjes së arsyeshme se me masën edhe më tutje mund të fitohen të dhëna në interes për procedurën. Neni 260, al. 2 dhe 3.

²⁴⁹ Грујевски, Г., (Злоупотреба на посебните истражни мерки (2015), Скопје, fq. 85.

²⁵⁰ Камбовски, В., Организиран криминал (2005), Скопје, fq. 368.

²⁵¹ Lukić, T. Posebnosti krivičnog postupka za organizovani kriminal, terorizam i korupciju (2008), Novi Sad, fq. 202-216.

- elektronike, kontrollohen kontaktet dhe përmbajtja e mesazhe të dërguara ose letrave.²⁵² Shikimi në komunikimet telefonike ose komunikimet tjera të realizuara elektronike dhe plotësimi i masës ndjekja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera të realizuara elektronike, e cila për nëpunësit operativ është masë operative dhe drejtuese.
- 7) **Grumbullimi i simuluar i sendeve.** Kjo masë konsiston në blerjen e sendeve që janë rezultat i veprës penale ose shërbejnë për kryerjen e veprës penale. Blerjen e bën policia ose persona tjerë të cilët për atë janë të përgatitur nga nëpunësit policorë. Blerja e simuluar e sendeve është e rëndësishme tek veprat penale specifike, të tilla si: vepra penale të lidhura me korrupsionin, vepra penale të lidhura me trafikimin me drogë, njerëz dhe armë, falsifikimin e parave etj. Gjatë ndërmarrjes të kësaj forme të masës hetimore vullneti i të dyshuarit është i lirë, ndërsa edhe të drejtat dhe liritë e tij janë të mbrojtura.²⁵³
- 8) **Dhënia dhe pranimi i simuluar i ryshfetit.** Dhënia dhe pranimi i simuluar i mitës më shpesh përdoret për dëshmimin e veprës penale korrupsion. Kjo është e nevojshme organi policorë të përgatisë person tjetër për ndërmarrjen e këtij veprimi, kështu që jepen më shumë kartëmonedha të shënuara për ryshfet. Për grumbullimin e njohurive dhe provave të rëndësishme për procedurën penale, organi policor ose personi tjetër i cili e ndërmer këto veprim, nuk i nënshtrohet përgjegjësisë penale nëse ndërmerren veprime në kufij të urdhrat të lëshuar. Kjo masë paraqet, gjeçësisht nënkupton, pjesëmarrjen fiktive në kryerjen e veprës penale të simuluar dhënia dhe pranimi i ryshfetit nga i denoncuari i veprës penale, të cilit i është ofruar ryshfet që të kryej ose të kryejë shërbime dhe punë të caktuara.²⁵⁴
- 9) **Dorëzimi dhe transporti i kontrolluar i personave dhe sendeve.** Dorëzimi dhe transporti i kontrolluar i personave dhe sendeve aplikohet për shkak të zbulimit dhe dëshmimit të veprave penale të lidhura me drogat narkotike, trafikimin me njerëz etj. Në organizatat kriminale ndërkombëtare ekziston ndarje e qartë e roleve, kështu që është shumë e vështirë të kontrollohen në lidhje me veprat penale konkrete. Gjatë zbatimit të kësaj mase aplikohet edhe ndjekja e fshehur dhe incizimi tonik i personave dhe sendeve, ndërsa ndonjëherë edhe mbikëqyrjen dhe incizimin teknik të bisedave telefonike. Kur flitet për iniciativën për dërgimin e kontrolluar ndërkombëtarë duhet të dallohen dy situata: a) situatë kur gjatë kontrollit doganorë do të gjendet dërgesë e dyshuar që gjendet në ngarkesë ose afër ngarkesës, ndërsa destinimi përfundimtarë është jashtë shtetit tonë dhe b) kur informatori ose agjenti i fshehur drejtpërdrejtë merr pjesë në transportin e dërgesave të dyshuara gjatë dërgesës së kontrolluar. Dërgesat e kontrolluara mund të ndahen në ato të cilat kryhen në zona të më shumë vendeve dhe ato të cilat kryhen në zonën e një vendi. Kur flitet për dërgesat e kontrolluara në zonën e më shumë vendeve, ato mund të ndahen në: a) ato që rrjedhin nga vendi jonë, ndërsa destinacioni përfundimtarë është vendi tjetër, b) ato që rrjedhin nga vendi tjetër, ndërsa destinacioni përfundimtarë është vendi jonë, dhe c) ato që rrjedhin nga vendi tjetër, ndërsa kalojnë nëpër vendin tonë, ndërsa destinacioni përfundimtarë është vendi i tretë. Vetë kontrolli i transportit ilegal në praktikë mund të realizohet në mënyra të ndryshme në varësi nga mjeti transportues me të cilin transporti bëhet dhe mundësitë faktike për ndjekjen e tij në çdo rast konkret.²⁵⁵ Duke pasur parasysh teknologjinë bashkëkohore, kjo masë është e mundur të zbatohet në distancë të caktuar hapësinore me përdorimin e pajisjeve teknike bashkëkohore për mbikëqyrjen teknike, vëzhgimin, orientimin ose pozicionimin (GPS). Nëse përdoret sistem global për pozicionimin, në mjetin transportues me të cilin bëhet transporti ilegal fshehurazi vendoset pranues të integruar me modem. Nëse merr sinjal nga sateliti, në bazë të asaj që e cakton pozicionin e automjetit, ndërsa sinjali që e definojnë atë pozicion të njejtin pozicion e dërgon përmes modemit në qendrën operative përgjegjëse për kontrollin e transportit. Pozicioni i marë në qendrën përmes softuerit përkatës direkt tregohet përmes hartës topografike të digjitalizuar. Në këtë mënyrë në çdo moment mund të caktohet pozicioni i transportit, vetë harta dhe drejtim i detajuar i lëvizjes së tij.²⁵⁶
- 10) **Përdorimi i personave me identitet të fshehur për përcjelljen dhe grumbullimin e informacioneve ose të dhënave.** Hetuesit e fshehur në literaturë definojnë si nëpunës policorë të cilët me identitet të ndryshuar (legjenda) hynë në mjedisin kriminal që të mbledhin informacione të

²⁵² Николоска, С., *Економска криминалистика*, Ван Гог, Скопје, 2015, fq. 36.

²⁵³ Lukić, T., *Posebности krivičnog postupka za organizovani kriminal, terorizam i korupciju* (2008), Novi Sad, fq. 174.

²⁵⁴ Лукић, Т., *Доказне радње у кривичном поступку* (2001), Нови Сад, fq. 94-100.

²⁵⁵ Иванова, Е., Донева, Н., *Современи истражни методи на државите членки на ЕУ, со осврт на нивната имплементација во македонската легислатива* (2014), Штип, fq. 227-231.

²⁵⁶ Лукић, Т., *Доказне радње у кривичном поступку* (2001), Нови Сад, fq.94-100.

dobishme për zbulimin, dëshmimin, sqarimin dhe parandalimin e veprave penale (edhe atë sidomos nga fusha e krimit të organizuar).

Personat me identitet të fshehur janë pjesëtarë të policisë gjyqësore ose persona tjerë, të cilët me pëlqim të prokurorit publik kryejnë hetim nën identitet të fshehur ose të ndryshuar. Për nevojat e këtyre personave mund të përgatiten, ndryshohen dhe përdoren dokumente personale dhe të tjera. Personat me identitet të fshehur kanë të drejtë me identitetin e fshehur të marrin pjesë në qarkullimin juridik. Organet shtetërore kompetente dhe personat tjerë juridik janë të obliguar të përgatitin dokumente për identitetin e ndryshuar. Të punësuarit në organet shtetërore dhe personat juridik janë të obliguar të ruajnë si informacion i klasifikuar të gjitha të dhënat dhe informacionet në lidhje me përgatitjen e dokumenteve për identitetin e ndryshuar. Mbrojtja e fshehtësisë së identitetit të personave për hetimin me identitet të fshehur arrihet me ruajtjen në fshehtësi dhe pas përfundimit të procedurës, për shkak të mbrojtjes së jetës, integritetit fizik ose lirinë e këtyre personave dhe të afërmeve të tyre. Personat të cilët e ndërmarrin masën hetimore përdorimin e personave me identitet të fshehur për ndjekjen dhe grumbullimin e të dhënave dhe informacioneve mund të dëgjohen si dëshmitarë të mbrojtur dhe identiteti i tyre paraqet sekret shtetërorë.²⁵⁷

- 11) **Hapja e llogarisë bankare në të cilën mund të depozitohen mjetet që rrjedhin nga vepra e kryer penale.** Hapja e llogarive të simuluar në emër të individëve (persona zyrtarë) ose të firmave jo ekzistuese, ose regjistrimi i firmave jo ekzistuese, me qëllim subjektiv tjetër (personit fizik ose juridik), për të cilin ekzistojnë baza të dyshimit se merret me aktivitet kriminal, është me qëllim të mundësojë kontakt afarist dhe transaksione në atë llogari ose me atë firmë, ndërsa me këtë edhe sigurimin e provave për aktivitetin kriminal (pagesën e ryshfetit, larjen e parave etj). Kjo masë nëpunësve operativ të policisë gjyqësor u mundëson operacione financiare të finguara dhe kanë për qëllim shikimin ose përcaktimin e sistemit të transaksioneve kriminale.²⁵⁸
- 12) **Regjistrimi i simuluar i personave juridik ose përdorimi i personave ekzistues juridik për mbledhjen e të dhënave.**²⁵⁹ Me regjistrimin e simuluar të personave juridik ose përdorimin e personave ekzistues juridik për mbledhjen e të dhënave dhe vendosja në marrëdhënie fiktive me këto firma më shpesh përcaktohen format paraqitëse të krimit ekonomik, mënyrën e kryerjes të aktiviteteve kriminale, ndërsa në kombinim me lloje tjera të masave të veçanta hetuese policia gjyqësore përcakton edhe persona tjerë të përfshirë në këtë lloj të aktivitetit kriminal.²⁶⁰

4. VEPRAT PENALE PËR TË CILAT MUND TË PËRCAKTOHEN MASAT E VEÇANTA HETUESE

Ligjvënësi parashikon zbatimin e masave të veçanta hetuese në rast kur ka bazë të dyshimit për ekzistimin e veprave penale ekzistuese ose formave paraqitëse të veçanta të tyre (më detaisht shiko neni 253 të LPP-së):

- Për vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg prej së paku katër vitesh, e që përgatiten, vijon kryerja ose janë kryer nga ana e një grupi të organizuar, bande ose shoqërie kriminale,
- Për veprat penale vrasje; grabitje; ndërmjetësim në prostitucion; paraqitja e materialit pornografik para të miturit; prodhim dhe distribuim i pornografisë së fëmijeve; mashtrim për dhunim ose veprim tjetër seksual të të miturit i cili nuk i ka mbushur 14 vjet; prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekurzorëve; dëmtim dhe ndërhyrje e paautorizuar në sistemin kompjuterik; zhvatje; shantazh; përvetësim i të mirave nën mbrojtje të përkohshme ose trashëgimisë kulturore ose rariteteve natyrore; eksportim, respektivisht nxjerrja jashtë shtetit të të mirave nën mbrojtje të përkohshme ose trashëgimi kulturore ose rariteteve natyrore; tjetërsim i trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë të pronësisë shtetërore; larje e parave dhe të hyrave tjera ilegale dhe kontrabandim; mashtrim doganorë; keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar; vjedhje në detyrë; mashtrim në detyrë; shërbim në detyrë; marrje e ryshfetit; dhënie e ryshfetit, ndërmjetësim i paligjshëm; ndikim i paligjshëm mbi dëshmitarë; organizim kriminal; organizatë terroriste; terrorizim, financimi i terrorizmit.

²⁵⁷ Më shumë shiko në Kapitullin e këtij libri që ka të bëjë me veprimet informative-kriminalistike.

²⁵⁸ Камбовски, В. Организиран криминал (2005), Скопје, fq.377.

²⁵⁹ Бужаровска, Г., Калаџиџев, Г., Мисовски, Б., Димоски, Д., Казнено процесно право (2015) fq.190-191.

²⁶⁰ Види: Николоска, С., Економска криминалистика, Ван Гог, Скопје., 2015, fq. 363.

- Për vepra penale kundër shtetit, vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare.²⁶¹

Me urdhrin të përcaktohet zbatimi i masave të veçanta hetuese kundër personave të cilët: kanë kryer vepra penale për të cilat sipas ligjit mund të përcaktohen masat e veçanta hetuese, ndërmarrin veprime të kryerjes së veprës penale për të cilat sipas ligjit mund të përcaktohen masat e veçanta hetuese, përgatitin kryerjen e veprës penale, për të cilat sipas ligjit mund të përcaktohen masat e veçanta hetuese kur përgatitja është e dënueshme sipas dispozitave të Kodit Penal.²⁶²

5. MËNYRA E MIRATIMIT TË MASAVE TË VEÇANTA HETUESE

Kompetencat për miratimin e masave të veçanta hetuese ndahen në dy grupe:

Njëri grup i masave (përcjellja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike në procedurën e përcaktuar me ligj të veçantë; përcjellja dhe incizimi në shtëpi, lokal të mbyllur ose të rrethuar që i takon asaj shtëpie ose lokal afarist të shënuar si privat ose në automjet dhe hyrje në ato lokale për krijimin e kushteve për ndjekjen e komunikimeve; përcjellja dhe incizimi i fshehtë i personave dhe sendeve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose lokalit afarist të shënuar si privat; shikimi i fshehtë dhe kontrollimi i sistemit kompjuterik; kërkimi automatik ose në mënyrë tjetër, kërkimi dhe krahasimi i të dhënave personale) pas kërkesës të arsyetuar të prokurorit publik, përcakton gjykatësi i procedurës paraprake me urdhër me shkrim.

Grupi i dytë i masave (shikimi në komunikimet telefonike ose komunikimet tjera të realizuara elektronike; grumbullimi i simuluar i sendeve; dhënia dhe pranimi i simuluar i rryshfetit, dorëzimi dhe transporti i kontrolluar i personave dhe sendeve; përdorimi i personave me identitet të fshehur për ndjekjen dhe grumbullimin e informacioneve ose të dhënave; hapja e llogarisë bankare në të cilën mund të depozitohen mjetet që rrjedhin nga vepra e kryer penale dhe regjistrimi i simuluar i personave juridik ose përdorimi i personave ekzistues juridik për mbledhjen e të dhënave) i përcakton prokurori publik me urdhër me shkrim.

Propozimi për zbatim të masave të veçanta hetuese iniciohet nga person i autorizuar nga policia gjyqësore ose prokurori publik sipas vlerësimit të tij. Prokurori publik paraqet kërkesë e cila duhet të përmbajë:²⁶³ të dhëna të sakta për personat apo lëndët për të cilat propozohet zbatimi i masave të veçanta hetimore, përcaktim të identitetit të personit, llojin e masës së veçanta hetimore që propozohet, me propozim për kohëzgjatje të zbatimit të saj dhe të përmbajë arsye mjaftueshëm sqaruese, duke paraqitur të gjitha njohuritë operative me të cilat disponon policia gjyqësore për personat konkret të përfshirë në propozim, shoqëruar me sqarim të argumentuar për atë se a ka ndërmarrë paraprakisht policia gjyqësore masa dhe aktivitete që të sigurojë në mënyrë tjetër të dhëna dhe prova relevante për iniciim të procedurës, rezultatet nga aktivitetet e tyre, respektivisht rreziqet dhe pengesat me të cilat janë ballafaquar gjatë sigurimit të tyre, me qëllim që prokurori publik, respektivisht gjykatësi i procedurës paraprake, të jetë vërtetë i bindur se ekziston domosdoshmëri për zbatim të këtyre masave të veçanta hetimore në këtë fazë të procedimit.

Nëse kërkesa e paraqitur pranohet atëherë gjykatësi i procedurës paraprake, gjegjësisht prokurori publik nxjerr urdhëresë me të cilën përcaktohet një ose më shumë masa të veçanta hetuese, dhe përmban:²⁶⁴ emrin ligjor të veprës penale, personin ose lëndët mbi të cilat do të zbatohen masat, mjetet teknike të cilat do të aplikohen, vëllimin dhe vendin e zbatimit të masave, njohuritë dhe dëshmitë mbi të cilat mbështeten bazat e dyshimit dhe arsyetimi i shkaqeve për të cilat të dhënat ose dëshmitë nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër, organin që duhet ta zbatojë urdhëresën dhe kohëzgjatjen e masës.

Urdhëresa për përcjelljen dhe incizimin e komunikimeve nga masat 1 dhe 2, duhet t'i përmbajë edhe llojin e sistemit telekomunikues, numrin e telefonit ose të dhënë tjetër për identifikimin e lidhjes telekomunikuese.

Urdhëresa mund të vlejë për personin: atë që ka kryer vepra penale, që ndërmerr veprim të kryerjes së veprës penale ose që e përgatit kryerjen e veprës penale për të cilët mund të shqiptohen këto masa, kur përgatitja është e dënueshme sipas dispozitave të Kodit penal. Urdhëresa mund të vlejë edhe për personin i cili pranon ose përcjell dërgesa nga i dyshuari ose i dyshuari përdor mjetin e tij komunikues. Nëse gjatë zbatimit të masës përcillen dhe incizohen komunikimet e personave që nuk janë përfshirë me urdhëresën, prokurori publik është i obliguar që t'i ndajë dhe ta njoftojë gjykatësin e procedurës paraprake. Me propozim të prokurorit publik, gjykatësi i procedurës

²⁶¹ Me ndërmarrjen e masave të veçanta hetuese nuk guxon të xitet kryerja e veprës penale. Kundër personit i cili i ndërmer masat e veçanta hetuese, nuk do të ndërmeret ndjekje penale për veprimin që paarqesin ndihmën për veprën penale, ndërsa janë kryer për shkak të sigurimit të të dhënave dhe provave për udhëheqjen e suksesshijme të procedurës penale.,

²⁶² Буцакоски, С., Тодоровска, Н., Практикум од областа на казнено право и криминалистиката (2014), fq. 87-89. Shiko edhe nenin 207 të LPP-së.

²⁶³ Andonova S., Bozhinovski A., dhe të tjerë, *Doracak për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve*, Geneva Centre for Security Sector Governance, Shkup, dhjetor 2019, fq. 53.

²⁶⁴ Neni 252 i LPP.

paraprake mund të urdhërojë që nga dokumentacioni i plotë nga zbatimi i masës të ndahen vetëm pjesët që kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën është dhënë urdhëresa.²⁶⁵ Nëse gjatë zbatimit të masës do të fitohen të dhëna për veprën penale e cila nuk është përfshirë me urdhëresën, masa do të vazhdohet vetëm nëse bëhet fjalë për veprën penale për të cilën mund të shqiptohen këto masa dhe të dhënat e mbledhura në atë mënyrë mund të përdoren si dëshmi në procedurën penale.²⁶⁶

Masat e veçanta hetuese i zbaton prokurori publik ose policia e jurisprudence²⁶⁷ nën kontroll të prokurorit publik. Gjatë zbatimit të masës policia e jurisprudence përgatit raport të cilin e dorëzon te prokurori publik me kërkesë të tij. Pas zbatimit të masave policia e jurisprudence përgatit raport të veçantë, të cilin e dorëzon te prokurori publik. Në raportin shënohen: 1) koha e fillimit dhe përfundimit të masës; 2) numri dhe identiteti i personave të përfshirë me masën dhe 3) përshkrimi i shkurtër për rrjedhën dhe rezultatet nga zbatimi i masës. Dokumentacioni i plotë i shkresës teknike dorëzohet te prokurori publik, në shtojcë të raportit të veçantë. Prokurori publik raportin e veçantë dhe dokumentacionin e plotë i dorëzon te gjykatësi i procedurës paraprake.²⁶⁸

6. KOHËZGJATJA E APLIKIMIT TË MASAVE TË VEÇANTA HETUESE

Në një nga lëndët më të mëdha gjyqësore, siç pohon Prokuroria publike për krimin e organizuar, ku janë të akuzuar 72 persona për kryerjen e dy veprave penale edhe atë: “Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar” dhe “Bashkimi kriminal”, në përputhje me Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë aplikuar masat e veçanta hetuese edhe atë: *përcjellja dhe incizimi i fshehtë i personave dhe sendeve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose lokalit afarist të shënuar si privat, grumbullimi i simuluar i sendeve si dhe dhënia dhe pranimi i simuluar i mitës, Përdorimi i personave me identitet të fshehur për përcjelljen dhe grumbullimin e informacioneve ose të dhënave.*

Në seancën kryesore para Gjykatës Themelore Shkup 1, Shkup, në rastin kur ishte sjell provë, gjegjësisht incizim audio dhe video material i emituar, si dhe dëshmitet e dëshmitarit të mbrojtur në prani të Gjykatësit hetues²⁶⁹ dhe Prokurorit publik. Provat e nxjerra janë kontestuar nga mbrojtja, për shkak të faktit që video materialet në disa vende nuk janë përcjellë me incizimin tonik si dhe për shkak të faktit për ekzistimin e afatit kohor në kamerën, ndërsa që ka lidhje me momentin e incizimit dhe kushtet reale të paraqitur në shënimin video, ndërsa e gjithë kjo ngre dyshim në lidhje me autenticitetin e materialit të grumbulluar, përkatësisht mundësia për përpunimin e tij.

Me rëndësi të veçantë për këtë lloj të procedurës provuese është **kohëzgjatja e aplikimit të tyre.**

Periudha kohore për të cilat miratohet aplikimi i masave të veçanta hetuese është e përcaktuar me ligj (shiko neni 260 të LPP-së). Masat e veçanta hetuese mund të zgjasin më së gjati katër muaj. Vazhdimin e masave të veçanta hetuese (përcjellja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike në procedurën e përcaktuar me ligj të veçantë; përcjellja dhe incizimi në shtëpi, lokal të mbyllur ose të rrethuar që i takon asaj shtëpie ose lokal afarist të shënuar si privat ose në automjetet dhe hyrje në ato lokale për krijimin e kushteve për ndjekjen e komunikimeve; përcjellja dhe incizimi i fshehtë i personave dhe sendeve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose lokalit afarist të shënuar si privat; shikimi i fshehtë dhe kontrollimi i sistemit kompjuterik) më së gjati për katër muaj tjerë mund ta lejojë gjykatësi i procedurës paraprake, e pas kërkesës së arsyetuar me shkrim të prokurorit publik.

Për veprat penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg prej së paku katër vitesh për të cilat ekziston dyshim i bazuar se janë kryer nga ana e grupit të organizuar, bandës ose shoqatës tjetër kriminale, gjykatësi i procedurës paraprake mund ta vazhdojë afatin për më së gjati 6 muaj, pas kërkesës me shkrim të prokurorit publik, e në bazë të vlerësimit të dobisë nga të dhënat e mbledhura me zbatimin e masës dhe në bazë të pritjes së arsyeshme se me masën edhe më tutje mund të fitohen të dhëna në interes për procedurën.

Disa masa (dorëzimi dhe transporti i kontrolluar i personave dhe sendeve; përdorimi i personave me identitet të fshehur për përcjelljen dhe grumbullimin e informacioneve ose të dhënave; hapja e llogarisë bankare në të cilën mund të depozitohen mjetet që rrjedhin nga vepra e kryer penale dhe regjistrimi i simuluar i personave juridik ose përdorimi i personave ekzistues juridik për mbledhjen e të dhënave), mund të vazhdojnë deri në realizimin e qëllimit për të cilin është përcaktuar masa, kurse më së voni deri në përfundimin e hetimit. Kundër aktvendimit të gjykatësit me të cilin nuk lejohet vazhdimi i kohëzgjatjes së masës, pas ankesës të prokurorit publik në afat prej 24 orësh, vendos këshilli i gjykatës.

²⁶⁵Neni 255 i LPP.

²⁶⁶Neni 263 i LPP.

²⁶⁷Policia e jurisprudence janë nëpunësit policorë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe pjesëtarët e Policisë Financiare dhe persona të autorizuar me ligj të Drejtorisë Doganore, të cilët punojnë në zbulimin e veprave penale. Neni 21 i LPP.

²⁶⁸Neni 258 i LPP.

²⁶⁹Sipas Ligjit për procedurë penale të vjetër.

Kur të arrihen qëllimet për të cilat janë përcaktuar masat e veçanta hetuese ose do të pushojnë së ekzistuari bazat për të cilat janë lejuar, organi që e ka dhënë ose vazhduar urdhëresën është i obliguar që menjëherë të urdhërojë ndërprerjen e masave. Nëse prokurori publik heq dorë nga ndjekja penale ose nëse të dhënat e mbledhura me masat e veçanta hetuese nuk kanë rëndësi për udhëheqjen e procedurës, do të asgjësohen nën mbikëqyrje të gjykatësit, e për këtë prokurori publik do të përgatisë procesverbal (Shiko nenin 261 të LPP-së).

Pas përfundimit të masave të veçanta hetuese, nëse kjo nuk e dëmton procedurën, me kërkesë të personit të tanguar, prokurori publik do t'ia dorëzojë urdhëresën me shkrim. Personi i tanguar kërkesën mund ta dorëzojë edhe në gjykatë. Zgjerimi i urdhëresës për zbatimin e masave të veçanta hetuese bëhet kur gjatë zbatimit të masës do të merren të dhëna për veprën penale e cila nuk është përfshirë me urdhëresën.²⁷⁰

7. PËRFUNDIM

- Masat e veçanta hetuese janë kategori penalo-juridike ndërkombëtare. Thuajse gjitha mekanizmat ndërkombëtarë kanë miratuar dokumente ku afirmojnë nevojën e përdorimit të masave të veçanta hetuese në luftë kundër krimit të organizuar, duke afirmuar parimin e proporcionalitetit mes qëllimit që arsyeton aplikimin e tyre dhe nevojën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke ndërtuar mekanizma të qartë ligjorë për mbykqirjen e aplikimit të masave dhe mbrojtje adekuate nga keqpërdorimi i tyre. Një përcaktim të tillë garanton “Gjyqi European për të drejtat e njeriut” duke siguruar mbrojtje gjyqësore të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe krijimin e mendimit të gjërë profesional, bazë për veprimet qyqësore nacionale të vendeve antare të Këshillit të Europës dhe krijimin e legjislacioneve nacionale që rregullojnë këtë çështje.

- Republika e Maqedonisë së Veriut ka një demokraci të re parlamentare, me një traditë konstitucionale në ndërtim, me tendencë për harmonizim gjegjësisht për afrim të legjislacionit nacional me atë të Unionit European dhe institucioneve euroatlantike, duke manifestuar një partneritet të qëndrueshëm në luftën kundër krimit të organizuar transnacional që rrezikon rendin shoqërorë nacional dhe atë ndërkombëtarë. Në një rrugëtim të tillë Republika e Maqedonisë së Veriut lëviz me hapa të shpejtë me dëshirë për përsosje të instrumenteve ligjore përkundër trendeve të përgjithshme ndërkombëtare, në luftë kundër kriminalitetit dhe mbrojtjes së sigurisë nacionale nga rreziqet e kohës. Duke favorizuar anën penalo juridike në drejtim të funksionit mbrojtës të së drejtës penale, novelat e fundit të Ligjit për përcjellje të komunikimeve jo vetëm që anashkalojnë komponentën garantuese të së drejtës penale, por krijojnë një konfuzion të përgjithshëm sa i takon vlerës së akteve ligjore dhe rradhitjes së tyre hierarkike. Kjo situatë shprehet gjatë aplikimit praktik të instrumenteve hetuese speciale duke krijuar hapsirë për volontarizëm shtetëtorë dhe josiguri juridike të qytetarëve.

- Për fat të keq mund të konstatojmë së në Republikën e Maqedonisë së Veriut mungon një kontrollë civil me kompetencë egzekutive për mbrojtjen gjegjësisht pengimin e cënimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë aplikimit të masave të veçanta hetuese, me theks të veçantë mbi aplikimin e përgjimit gjegjësisht përcjelljen e komunikimeve. Garancat normative në Ligjin për përcjellje të komunikimeve janë të pamjaftueshme përkundër zgjidhjeve kategoriale që rregullojnë mënyrën e aplikimit të këtyre masave.

Jemi të mendimit se në Republika e Maqedonisë së Veriut kemi përgjim sistematik i cili procedohet vetëm në raste kur duhet të formohet ndonjë lëndë gjyqësore kundër një individi të caktuar. Në raste kur materiali i mbledhur me anë të përgjimit për çështje procedurale ose përmbajtësore (nëse është mbledhur në mënyrë joligjore dhe nuk ka përmbajtje të nevojshme), nuk mund të përdoret si provë, d.m.t. ska ndonjë vlerë dëshmuuese në procedurë penale, atëherë ai shfrytëzohet si indicje për të siguruar prova të llojeve tjera, apo indicje me ndikim për vendimarrje gjatë shqyrtimit të rastit nga gjyqi, që paraqet një presedan i praktikikës gjyqësore të RMV-së, nga shkaki se këta prova si të tilla në bazë të LPP duhet të tërhiqen krejtësisht nga shkresta e lënës gjyqësore.

- Sa i takon mbykqyrjes institucionale të aplikimit të masave të veçanta hetuese, Komisioni parlamentar dy vite pas konstituimit nuk funksionon. Ndërsa mbykqyrja gjyqësore kohëve të fundit shënon një lëvizje progresive në drejtim të vlerësimit dhe vendimarrjes kontra urdhëresave dhe mënyrës së aplikimit të masave të veçanta hetuese duke suspenduar përdorimin e tyre në procedurë penale si provë. Por kjo mbaron këtu. Ligji nuk përmban mekanizma të qartë për kompenzim të personit lëndë e përgjimit të pautorizuar dhe të paryeshëm. Nga ana tjetër duke u nisur nga mentalitetit i qytetarëve dhe vetëdija për mënyrën e funksionimit të sistemit gjyqësorë në RMV, personat e dëmtuar lëndë e përgjimit zakonisht nuk inicojnë ndonjë procedurë të veçantë për kompenzim duke mbetur të kënaqur me faktin e menjanimin të provave nga procedura penale që zhvillohet kundër tij. Rol të rëndësishëm në mbykqyrjen e aplikimit të masave të veçanta hetuese kanë organizatat joqeveritare nëpërmjet mbykqirjes joinstitucionale me një efekt të shprehur në nxitjen e organeve kompetente që ti përnbushin obligimet e tyre ligjore.

²⁷⁰ Бужаровска, Г., Калајциев, Г., Мисовски, Б., Димоски, Д., Казнено процесно право (2015), 261. Shiko nenin 232 dhe 263 të LPP.

- Mrojtjen institucionale të lirive dhe të drejtave të njeriut e mundësojnë gjyqet nacionale dhe në veçanti Gjyqi European për të drejtat e njeriut, vendimet e ti cilit përveç që afirmojnë Konventën europiane për të drejtat e njeriut, kontribuojnë në harmonizimin e legjislacionit dhe praktikës gjyqësore të vendeve anëtare të Këshillit të Europës dhe më gjërë. Gjyqi synon aplikim të masave të veçanta hetuese vetëm në kuadër të ligjeve nacionale, që duhet të jenë të qartë dhe precize, që paraprakisht do ti njohtojnë qytetarët për mënyrën dhe kushtet e aplikimit të masave dhe të drejtën e tyre për të kontestuar autenticitetin e materijalit të grumbulluar dhe të drejtën e mbrojtjes ligjore nga një trajtim procedural i lloit të tillë në kushte joligjore
- Republika e Maqedonisë së Veriut disponon me kapacitete minimale normative dhe institucionale për një luftë të suksesshme kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Institutet juridike temë e këtij materijali mundësojnë një qasje të drejtpërdrejtë te institucioneve kompetente ndaj gjurmëve të kriminalitetit, zbulimin e kryerësve dhe grumbullimin e provave për realizimin e një procedure të suksesshme penale proporcionale me nevojën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe akte ndërkombëtare.

8. REKOMANDIME

1. Modernizimi legjislativ në fushën e së drejtës ndëshkuese procedurale me theks të veçantë mbi Ligjin për përcjellje të komunikimeve me novelat e tij dhe LPP krijoi një konfuzion hierarkik ligjorë dhe më pastaj një gjendje ku Maqedoninë e këthen në fillim pasi që këto ligje mundësojnë një ndërhyrje maksimale në privatësinë e individit duke shëndëruar shtetin në një “vesh të madh” sikurse ai i viti 2001 dhe nga viti 2008-2015. Iniciativat e ngritura para qyqit Kushtetues shprehin shqetësimin e gjytetarëve dhe organizmave të ndyshëm joqeveritarë përkundët komcionit të aparatit shtetërorë që e sigurojnë labirinthet procedurale.

Rekomandojmë që konfuzionin ligjorë në lidhje me aplikimin e masave të veçanta Gjyqet e Republikës së Maqedonisë së Veriut ta tejkalojnë duke aplikuar Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut si pjesë e sistemit juridik, në të cilat parashikohen mekanizma të qartë për nevojën, mënyrën e aplikimit dhe mbrojtjen e privatësisë së qytetarëve, që s’do mend se parashikojnë një zgjidhje më të afancuar në favor të qytetarëve.

2. Fillimisht rekomandojmë për nevojën e një harmonizim normativ nacional që do të ishte bazë e një harmonizimi me aktet dhe normat ndërkombëtare, në drejtim të efikasitetit të luftës kundër krimit të otganizuar transnacional në kuadër të mekanizmave të unjisuar juridik, njëherit duke vënduar në fokus mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut të garantuara me akte universale.

3. Republika e Maqedonisë së Veriut si anëtarë në NATO dhe si vend kandidat për integrim në Unioni European, ka nevojë për një kultivim institucional dhe teknik në drejtim të përsosjes së mekanizmave dhe mjeteve hetuese përkundër zhvillimit tekniko-teknologjik në favor të zbulimit të krimit transnacional dike mos haruar edhe nevojën e mbrojtjes së dëshmitarëve të mbrojtër dhe dëshmitarëve- viktimë .

5. Aplikimi i përgjimit të kushtëzohet me garanca gjyqësore se në afat sa më të shkurtër do të asgjësohen provat e grumbulluara të cilat nuk kanë ndonjë vlerë procedurale dhe për të njëjtën të informohet pala e interesuar. Legjislacioni dhe institucionet të krijojnë besim se provat e grumbulluara me përgjim nuk do të shfrytëzohen për asnjë qëllim tjetër përveç të atij që është potencuar në kërkesë gjegjësisht urdhëresën për përgjim.

6. Egziston nevoja e kultivimit të mekanizmave të qëndrueshmë për mbykqyrjen e aplikimit të masave të veçanta hetuese, fjalën e kemi për mbykqyrjen gjyqësore e në ate politike (parlamentare), me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore.

LITERATURA E SHFYTËZUAR

- Бужаровска, Г., Калајџиев, Г., Мисовски, Б., Димоски, Д. (2015). Казнено процесно право
Буџакоски, С., Тодоровска, Н. (2014). Практикум од областа на казнено право и криминалистиката
Грујевски, Г. (2015). (Зло)употреба на посебните истражни мерки, Скопје
Иванова, Е., Донева, Н. (2014). Современи истражни методи на државите членки на ЕУ, со осврт на нивната имплементација во македонската легислатива, Штип
Камбовски В. (2005). Организиран криминал, Скопје
Лукић, Т. (2001). Доказне радње у кривичном поступку, Нови Сад
Николоска, С. (2015). *Економска криминалистика*, Ван Гог, Скопје
Николоска, С. (2015). *Економска криминалистика*, Ван Гог, Скопје
Andonova, S., Bozhinovski, A., dhe të tjerë, (2019). *Doracak për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve*, Geneva Centre for Security Sector Governance, Shkup,
Lukić, T. (2008). Posebnosti krivičnog postupka za organizovani krminal, terorizam i korupciju
Etemi, N. (2020). Taktika Kriminalistike – 2, Gostivar

Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 150/110

Ligji për ndjekjen e komunikimeve, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.4/09, 116/12

Ligji për komunikimet elektronike, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18, 21/18

Ligji për Agjencinë teknik-operative, Gazeta Zyrtare e Rm-së, nr.71/18

https://www.analyticamk.org/images/Files/impossible_mk_final_95921.pdf